



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Lokalne Samouprave Administracije*  
*Ministry of Local Government Administration*

---

**RAPORTI PËR VLERËSIMIN E TRANSPARENCËS NË KOMUNA**  
**JANAR-DHJETOR 2023**



Prill, 2024






## Përmbajtja

Hyrja	4
Qëllimi	5
Përmbledhje ekzekutive	6
Transparenca e punës së kuvendeve të komunave	6
Njoftimet për mbledhjet e kuvendit komunal	7
Komiteti për Politikë dhe Financa	8
Komiteti për Komunitet	8
Publikimi i akteve të kuvendeve të komunave	9
Vendimet dhe Rregullore të kuvendit komunal	10
Procesverbalet	11
Transmentimi online i mbledhjeve të kuvendit komunal	12
Publikimi i planit të kuvendit dhe strategjive komunale	13
Harta zonale	13
Plani i veprimt për transparencë	14
Rregullore për transparencë	16
Transparenca e kryetarit të komunës	17
Publikimi i raportit të kryetarit	17
Takimet e kryetarit	17
Raporti për Qasje në dokumente Publike	19
Transparenca financiare	20
Publikimi i planit buxhetor	21
<b>Error! Bookmark not defined.</b>	
Publikimi i KAB-it	21
Raportet periodike financiare	22
Raportit vjetor financiar	22
Takime buxhetore	23
Raporti i auditorit të jashtëm	24
Lista e investimeve kapitale	24
Transparenca e prokurimit publik	25
Publikimi i planit të prokurimit	25
Publikimi i raportit të prokurimit	26
Zbatimi i standardeve minimale të konsultimit publik	27
Planifikimi i konsultimeve publike në ueb faqen zyrtare	27
Projekt propozimet të publikuara në faqen zyrtare	28
Raportet për konsultime publike	29
Njoftimet për konsultim publik në komuna	29
Përfundime/rekomandime	31





*Të drejtat e autorit © 2024*

*Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e dokumentit nuk mund të kopjohet, shumëzohet dhe të përdoret, në cilën do formë (elektronike dhe fizike) apo të përshkruhet pa lejen me shkrim të autorit - MAPL.*

*Titulli; Raport për vlerësimin e transparencës Janar- Dhjetor 2023*

*Ekipi realizues: Nazmije Krasniqi, Udhëheqëse e Divizionit për Transparencë Komunale /DPTK*

*Majlinda Shaqiri, Zyrtare e Lartë për Transparencë Komunale /DPTK*





## **HYRJE**

*Transparenca është një nga parimet më të rëndësishme të qeverisjes së mirë. Transparenca është detyrim i autoriteteve qendrore dhe lokale për të ndarë informacione me qytetarët, për të marrë vendime të drejta dhe të bazuara në informacion. Ajo shërben si mjet për t'i ngarkuar zyrtarët me përgjegjësi për sjelljen dhe punën e tyre. Informimi, përfshirja e qytetarëve në vendimmarrje dhe llogaridhënia janë tri komponentët më me peshë të ushtrimit të pushtetit demokratik. Administrata publike konsiderohet si një ndër sektorët më të rëndësishëm të një shteti, si dhe, është promotor i zhvillimeve dhe ndryshimeve sociale. Qeverisja demokratike do të thotë se përtej informimit, qytetarët duhet të dëgjohen dhe të jenë pjesë përbërëse në procesin e politik bërjes. Autoritetet lokale duhet në vazhdimësi të japin informacione për punën e tyre, të shfrytëzojnë mekanizma për konsultim që i'u përgjigjen më së miri qytetarëve, t'i bëjnë grupet e interesuara pjesë të politikbërjes, t'u japin llogari në baza të rregullta, si në fazën e planifikimit ashtu edhe gjatë draftimit dhe zbatimit të këtyre politikave.*

*Sot me miliona njerëz, në baza ditore varen nga qeveritë e tyre për shërbimet e ofruara. Në funksion të kësaj, cilësia e shërbimeve komunale dhe administrimi efikas i kërkesave të qytetarëve varen edhe nga mënyra e plasimit të informatave, sistemeve të informacionit që aplikohen, teknologjive, teknikave të konsultimit, si dhe veprimeve të tjera përcjellëse të organeve të administratës publike.*

*Përdorimi i ueb-faqeve është një nga mekanizmat për të mbajtur të informuar qytetarët lidhur me aktivitetet e organeve komunale. Përdorimi i tyre rregullohet me akt nënligjor të qeverisë, i cili i obligon të gjitha institucionet publike të japin informacione për punën e organeve të tyre, shërbimet e ofruara, përmbajtjes dhe përditësimin të dokumenteve zyrtare, informacionet për përgjegjësitë e njësi-ve organizative të komunave, dokumentet financiare, prokurimit etj. Po ashtu, informacioni i publikuar në ueb faqe duhet të jetë në përputhje me kërkesat dhe standardet gjuhësore.*

*Në vitin 2018, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka ri-dizajnuar ueb-faqet e 38 komunave. Ri-dizajnimi mundësoi unifikimin e standardeve të publikimit të informatave, dhënien e mundësi-ve për aplikim online për leje ndërtimi, paraqitjen e kërkesave dhe shqetësimeve në fushën e sigurisë në bashkësi, si dhe transmetimin online të mbledhjeve të kuvendeve komunale (KK). Përveç karakterit informues, ueb-faqet komunale mundësojnë edhe procese administrative dhe ndërli- dhen me ueb-faqe tjera, të cilat shërbejnë për procesin e konsultimit publik. Ndërlidhja e tyre me sistemin e intranetit në komunë u mundëson qytetarëve të parashtrajnë online të gjitha kërkesat e tyre, drejtorive përkatëse të komunës.*





## QËLLIMI

Raporti për vlerësimin e transparencës për periudhën Janar-Dhjetor 2023, pasqyron nivelin e transparencës së komunave në përmbushjen e obligimeve ligjore për informim të qytetarëve lidhur me aktivitetet, aktet komunale dhe dokumentet publike që duhet të jenë të hapura për publikun.

Raporti ka për qëllim informimin e drejtë të institucioneve qendrore, qytetarëve, organizatave joqeveritare dhe grupeve të interesit, për gjendjen reale të ueb faqeve zyrtare të komunave, duke ngritur kështu përgjegjësinë e organeve komunale dhe personave përgjegjës që të ndër marrin hapat konkret në zbatimin e veprimeve që do të ndikojnë në avancimin e mëtutjeshme të transparencës komunale.

Në kuadër të raportit, janë përfshirë të dhënat për 38 komuna të Republikës së Kosovës. Vlerësojmë se informacionet e ofruara në këtë raport, e në veçanti gjetjet e paraqitura do shërbejnë në të mirë të qeverisjes lokale, të rrisin përgjegjësinë institucionale dhe se organet e komunave të ndër marrin hapa konkret në avancimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.

Të dhënat e këtij raporti pasqyrojnë dallimin në mes të numrit të akteve të miratuara me ato të publikuara, numrin e akteve të kryetarit të komunës, publikimin e ftesave për mbledhjet e kuvendit komunal, komitetit për politikë dhe financa, komiteteve për komunitete, numrin e procesverbaleve për mbledhjet e kuvendit komunal, numrin e seancave të transmetuara online, publikimin e dokumenteve strategjike, planet e kuvendit komunal, raportet e kryetarit, takimet e kryetarit, transparencën financiare, transparencën e prokurimit dhe procesin i konsultimeve publike në komuna.

## METODOLOGJIA

Për hartimin e këtij raporti është përfshirë: metoda statistikore dhe krahasimore. Të dhënat e përdorura janë siguruar përmes monitorimit të ueb-faqeve të komunave. Të njëjtat janë krahasuar me:

- *Obligimet ligjore të kësaj fushe;*
- *Raportin zyrtar për funksionimin e komunave janar - dhjetor 2023 për qëllime krahasimore si dhe;*
- *Raportin për vlerësimin e transparencës janar- dhjetor 2022*





## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Funksionimi dhe përdorimi i ueb faqeve zyrtare të komunave rregullohet me Udhëzimin Administrativ Nr. 01/2015 për ueb-faqet e institucioneve publike. Përderisa në vitin 2018 është realizuar projekti për ridizajnimin e ueb-faqeve të gjitha komunave, në vitin 2019 ndryshimet e tyre kanë sjellë integrimin e sistemit të intranetit në ueb-faqet e komunave, ku qytetarët mund të adresojnë kërkesat për pajisje me dokumentet e gjendjes civile, por që dy vitet e fundit dhe kanë filluar të paraqiten problem në përditësimin e të dhënave dhe qasjen e dokumenteve dhe të informacionit.

Viti 2023 ka vazhduar të jetë sfidues për zyrat e informimit të komunave, për shkak të mos funksionimit të ueb faqeve zyrtare të komunave, që ka krijuar problem në përditësimin me të dhëna dhe funksionimin e rregullt të ueb faqeve zyrtare të komunave. Qasja në ueb faqe zyrtare të komunave nuk është e qasshme gjatë gjithë kohës dhe krijon vështirësi në hapjen e ngadalësuar të dokumenteve, saktësinë e të dhënave dhe ka raste kur ueb faqet zyrtare të komunave dalin nga sistemi dhe nuk lejojnë marrjen e informacioneve për dokumente, që duhet të jenë të arritshme për publikun, brenda afateve kohore.

Raporti për vlerësimin e transparencës komunale për periudhën Janar-Dhjetor 2023, pasqyron transparencën komunale dhe gjitha problemet si rrjedhojë e mosfunksionimit të ueb faqes zyrtare të komunave. Pavarësisht gjendjes jo stabile të funksionimit të ueb faqeve zyrtare komunat kanë vazhduar me publikimin e aktiviteteve të planifikuara, duke i kushtuar vëmendje transparencës dhe informimit të qytetarëve për takime të drejtpërdrejta, përfshirjes aktive të qytetarëve, grupeve të interesit, përdorimit të sistemeve elektronike të informacionit, si dhe metodave të tjera që do të ndikojnë në avancimin e transparencës për punën e kuvendeve komunale, komiteteve, takimeve publike, aktiviteteve të prokurimit, akteve të publikuara, transparencës financiar, konsultimet publike etj.

Raporti për vlerësimin e transparencës komunale i periudhës Janar-Dhjetor 2023, vlerëson transparencën e 38 komunave, duke përfshirë indikatorë të cilët janë edhe obligim ligjor i institucioneve komunale. Në raport përfshihet, krahasimi i publikimit të aktiviteteve të komunave në raport me detyrimet ligjore, informimi me afat i qytetarëve lidhur me publikimin e akteve të kuvendit komunal, transparencës së kryetarit të komunës, ftesave dhe procesverbaleve të kuvendit komunal, komiteteve obligative, planet dhe dokumentet strategjike, aktivitetet financiare, prokurimit si dhe konsultimet publike etj.





## TRANSPARENCA E PUNËS SË KUVENDEVE TË KOMUNAVE

Kuvendi i Komunës është organi më i lartë përfaqësues i pushtetit lokal dhe njëkohësisht organ i autorizuar ligjërisht për mbikëqyrjen e ofrimit të shërbimeve nga ekzekutivi i komunës, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Për të ushtruar funksionin e tij, kuvendi i komunës duhet të mblidhet rregullisht në mënyrë që të kryej përgjegjësitë në kuadër të kompetencave ligjore komunale, për të miratuar aktet e nevojshme normative për funksionimin e komunës, akte të cilat kërkohen shprehimisht me legjislacionin në fuqi apo ato të cilat ligjet i lënë të hapura për tu nxjerrë varësisht nga nevojat e komunave, si dhe për të diskutuar dhe vendosur çështjet me interes të komunës.

## NJOFTIMET PËR MBLEDHJET E KUVENDEVE TË KOMUNAVE

Ligji për vetëqeverisje lokale Nr. 03/L-040 ka përcaktuar standardet minimale që i referohen mbajtjes së takimeve të kuvendit të komunës, për të siguruar punën e këtij organi. Ky ligj ka rregulluar mbajtjen e së paku 10 mbledhjeve në vit të kuvendit të komunës, pesë prej të cilave duhet të mbahen në gjashtëmujorin e parë të vitit. Para çdo mbledhje të kuvendit, kryesuesi obligohet që së paku 7 ditë pune para mbledhjeve të rregullta dhe, 3 ditë pune para mbledhjeve të jashtëzakonshme, si dhe brenda ditës në rastet e mbledhjeve urgjente, të njoftoj publikun përmes shpalljes së njoftimit në ueb-faqen zyrtare të komunës, rrjetet sociale apo media-t.

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2023, janë publikuar 422 ftesa të Kuvendit Komunal, nga 34 komuna, ndërsa 4 komuna nuk kanë publikuar asnjë ftesë të kuvendit komunal dhe nuk kanë përmbushur këtë obligim ligjor.

Referuar të dhënave nga Raportit i Funksionimit të Komunave gjatë vitit 2023, kuvendet e komunave të Republikës së Kosovës kanë mbajtur 534 mbledhje, ndërsa janë publikuar 422 ftesa të Kuvendit nga 34 komuna, bazuar në këto të dhëna konstatohet se mungon publikimi i 112 ftesave të tjera të kuvendit.

Komunat të cilat nuk kanë publikuar asnjë ftesë të K.K. janë Zubin Potok, Zveqan, Leposaviq, Mitrovicë e Veriut.

Në vijim, është paraqitur figura me të dhëna e komunave për publikimin e njoftimeve për mbledhje të kuvendit komunal.





Fig.1. Publikimi i ftesave për mbledhjet e Kuvendeve Komunale

### Komitetin për Politikë dhe Financa

Bazuar në Ligjin për vetëqeverisje lokale Nr. 03/L-040, neni 51, paragrafi 51.1 ka përcaktuar se kuvendet e komunave themelojnë komitetet e obligueshme; si Komitetin për Politikë dhe Financa dhe Komitetin për Komunitete si komitete të përhershme.

Komiteti për politikë dhe financa është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, planeve dhe iniciativave, duke përfshirë dokumentet e planifikimit strategjik, kornizën buxhetore afatmesme, planin vjetor të prokurimit, rregulloren vjetore për tatimet, tarifrat dhe pagesat, planin vjetor të punës për auditimin e brendshëm, buxhetin vjetor dhe çdo ndryshim të buxhetit gjatë vitit fiskal, si dhe për marrjen e raporteve nga kryetari dhe dorëzimin e rekomandimeve në kuvendin e komunës.

Gjatë kësaj periudhës Janar-Dhjetor 2023, janë publikuar 290 ftesa për Komitetin për Politikë dhe Financa nga 28 komuna, ndërsa 10 komuna nuk kanë publikuar asnjë ftesë për mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa.

### Komiteti për komunitete

Komiteti për komunitete është përgjegjës për shqyrtimin e përputhshmërisë së autoriteteve komunale me ligjin në zbatim dhe për shqyrtimin e të gjitha politikave komunale, praktikave dhe aktiviteteve për t'u siguruar se të drejtat dhe interesat e komuniteteve respektohen plotësisht. Komiteti gjithashtu i rekomandon kuvendit të komunës masat që duhet të ndërmerren për të siguruar jetësimin e dispozitave që kanë të bëjnë me nevojën e komuniteteve për t'u avancuar, shprehur, mbrojtur dhe zhvilluar identitetin e tyre etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor, si dhe për të siguruar mbrojtje adekuate të drejtave të komuniteteve brenda komunës.

Për periudhën raportues janë publikuar 151 ftesat për Komitetin për Komunitete nga 20 komuna, ndërsa 18 komuna nuk kanë publikuar asnjë ftesa për komitetin për komunitetin.







Krahasuar me vitin 2022, numri i takimeve për komitetin për komunitetin ka shënuar rritje për 22 takime me shumë, por numri i komunave që kanë publikuar ftesat për komitetin për komunitete është i njëjtë.

Në vijim, është paraqitur figura me të dhëna lidhur me njoftimet për mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe njoftimet për mbledhjet e Komitetit për Komunitete për periudhën Janar-Dhjetor 2023.




Fig.2. Njoftimet për mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa si dhe Komitetit për Komunitete

Marrë parasysh njoftimet e publikuara nga Raporti për Vlerësimin e Transparencës për periudhën raportuese 2023, Komiteti për Politikë dhe Financa rezulton të jetë më aktiv në krahasim me Komitetin për Komunitete, që ka pasur intensitet më të ulët të takimeve të mbajtura në komuna.

## PUBLIKIMI I AKTEVE TË KUVENDEVE TË KOMUNAVE

Bazuar në Ligjin për vetëqeverisje lokale Nr. 03/L-040, Kuvendi i Komunës ka kompetencë miratimit e vendimeve dhe rregulloreve për zbatimin e ligjeve që prekin kompetencat në nivel lokal. Kuvendi miraton Statutin dhe Rregulloren e Punës, merr vendime, nxjerr rregullore dhe akte tjera të përgjithshme. Publikimi është një nga aspektet më të rëndësishme në procesin e aprovimit dhe hyrjes në fuqi të akteve të kuvendeve komunale, pas marrjes së konfirmimit të ligjshmërisë nga autoriteti mbikëqyrës. Gjithashtu, publikimi mundëson informimin e përgjithshëm për tërësinë e akteve, të cilat janë në fuqi në nivelin lokal, duke u bazuar në Rregulloren (MAPL) Nr.02 /2021 për procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve Komunale si dhe Udhëzimin Administrativ Nr.04/2023 për Administratë të hapur në komuna, që rregullojnë parimet, rregullat dhe procedurat për publikimin e akteve normative të komunës.

Sipas të dhënave nga Raporti i Funkcionimit të Komunave gjatë periudhës, Janar-Dhjetor 2023, janë miratuar 2210 akte, ndërsa të dhënat e Raportit për Vlerësimin e transparencës





pasqyrojnë se janë publikuar 2090 akte të kuvendeve komunale, prej të cilave 105 rregullore dhe 1985 vendime. Këto të dhëna pasqyrojnë se mungon publikimi i 120 akteve.

Në vijim, është paraqitur figura numri i akteve të publikuar nga 38 komunat.




Fig. 3 Publikimi i akteve nga komunat

### Vendime të Kuvendit Komunal

Bazuar në të dhëna e Raporti të Funkzionimit të Komunave 2023, janë miratuar 2090 vendime të Kuvendit Komunal, ndërsa të dhënat nga monitorimi i ueb faqeve zyrtare të komunave pasqyrojnë se janë publikuar 1985 vendime të Kuvendit nga 34 komuna, përderisa 4 komuna nuk kanë publikuar asnjë vendim, bazuar në këto të dhëna konstatojmë që 105 vendime nuk janë publikuar nga komunat.

Në vijim, është paraqitur figura me të dhëna për numrin e vendimeve nga komunat të publikuara gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2023.




Fig 4 Numri i vendimeve të publikuara të kuvendit komunal

### Rregullore të Publikuara

Sipas të dhënave nga Raporti i Funkzionimit të Komunave, gjatë kësaj periudhe nga kuvendet komunale janë miratuar 120 Rregullore, ndërsa të dhënat nga ueb faqet zyrtare të komunave konstatojnë se janë publikuar 105 rregullore nga 31 komuna.





Këto të dhëna pasqyrojnë se 15 rregullore të miratuar nga kuvendet komunal nuk janë të publikuar në ueb faqet zyrtare të komunave.

Në vijmë është paraqitur figura që pasqyron numrin e rregulloreve të publikuara nga komunat për periudhën Janar-Dhjetor 2023.




Fig. 5 Numri i rregulloreve të publikuara nga komunat

### Procesverbale nga mbledhjet e kuvendit të komunës

Udhëzimin Administrativ Nr. 04/2023 për Administratë të hapur në komuna, ka përcaktuar se komuna obligohet ti publikojë në ueb faqe zyrtare të saj, procesverbalet e mbledhjeve të kuvendit të komunës dhe komiteteve obligative .

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2023, janë publikuar 317 Procesverbale për mbledhjet e kuvendit komunal nga 29 komuna, ndërsa 9 komuna nuk kanë publikuar asnjë procesverbal nga mbledhjet e kuvendit komunal

Krahasuar me të dhënat e Raportit për Vlerësimin e Transparencës për vitin 2022, konstatohet se gjatë vitit 2023 kemi rënie në publikimin e procesverbaleve nga mbledhjet e kuvendit komunal, për tri (3) komuna më pak.

Komunat të cilat nuk kanë publikuar asnjë procesverbal të kuvendit janë si vijon: Deçan, Kllokot, Partesh, Ranillug, Zubin Potok, Zveçan, Leposaviq, Mitrovicë e Veriut, Mamushë.

### Procesverbale nga mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa

Referuar të dhënave nga monitorimi i ueb faqeve zyrtare të komunave, 26 komuna kanë publikuar 256 procesverbale të Komitetit për Politikë dhe Financa, ndërsa 12 komuna nuk kanë publikuar fare procesverbale nga mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Krahasuar me të dhënat nga Raporti për Vlerësimin e transparencës 2022, kemi rënie të lehtë për një (1)komune me pak për vitin 2023.





Komunat të cilat nuk kanë publikuar asnjë procesverbal të Komitetit për Politikë dhe Financa, janë : Fushë Kosovë, Graçanicë, Kllokot, Partesh, Ranillug, Shtërpce, Viti, Zubin Potok, Zveqan, Leposaviq, Mitrovicë e Veriut, Mamushë.

### Procesverbale nga mbledhjet e Komitetit për Komunitete

Gjithashtu, kur jemi të publikimi i procesverbaleve të Komitetit për Komunitete janë publikuar 166 procesverbale nga 17 komuna, ndërsa 21 komuna nuk kanë publikuar asnjë procesverbal për mbledhjet e Komitetit për Komunitete.

Sipas këtyre të dhënave vërehet një ngritje e lehtë prej 3 komunave më shumë se sa në vitin paraprak 2022, po ashtu një ngritje e lehtë edhe tek numri i publikimeve të procesverbaleve gjatë vitit 2023.

Komunat të cilat nuk kanë publikuar asnjë procesverbal të Komitetit për Komunitete janë si vijon; Deçan, Fushë Kosovë, Gjakovë, Glllogoc, Istog, Kllokot, Malishevë, Novobërdë, Obiliq, Partesh, Pejë, Prizren, Ranillug, Shtërpce, Viti, Vushtrri, Zubin Potok, Zveqan, Leposaviq, Mitrovicë e Veriut, Mamushë.

Në vijim, është paraqitur figura me numrin i përgjithshëm për procesverbalet e Kuvendeve Komunale, Komiteteve për Politikë dhe Financa si dhe procesverbalet nga Komunitetet për Komunitete.




Fig.6 Procesverbalet e kuvendit komunal, komitetit për politikë dhe financa dhe komiteti për komunitete

Referuar të dhënave nga Raportit i Funkcionimit të Komunave gjatë vitit 2023, kuvendet e komunave të Republikës së Kosovës kanë mbajtur 534 mbledhje, ndërsa të dhënat nga monitorimi i ueb faqet zyrtare të komunave për periudhën raportuese 2023, janë publikuar 422 ftesa për mbledhjet të kuvendit komunal.

Bazuar në këto të dhëna, konstatojmë se krahasuar me numrin e mbledhjeve të mbajtura, mungojnë 217 procesverbale, ndërresa në numrin e ftesave të publikuar për mbledhjet e kuvendit komunal mungojnë 105 procesverbale, realisht rezulton numër i madhe i procesverbaleve të pa publikuar.





### Transmetimi online i mbledhjeve të kuvendeve komunale

Bazuar në nenin 6 të Udhëzimit Administrativ Nr. 04/2023 për Administratë të hapur në komuna, organet përgjegjëse të komunës përmes faqes zyrtare transmeton mbledhjet e kuvendit komunal, duke përdorur pajisjet e nevojshme për transmetim. Organet e Komunës janë të obliguara të sigurojnë qasje aktive në përdorimin e sistemit të teleprezencës, me qëllim të krijimit të kushteve për monitorim dhe vlerësim të proceseve për mekanizmat monitorues të MAPL-së, palëve të interesuara dhe institucioneve tjera në mbledhjet e Kuvendit të Komunës, përmes stafit të autorizuar të komunës.

Sipas të dhënave nga monitorimi i ueb faqeve zyrtare të komunave për periudhën Janar – Dhjetor 2023, janë transmetuar 285 mbledhje online të kuvendit komunal prej 24 komunave, ndërsa 14 komuna nuk kanë transmetuar asnjë mbledhje online.

Krahasuar me të dhënat nga Raporti për Vlerësimin e Transparencës së Komunave për periudhën Janar-Dhjetor 2022, ku janë transmetuar 262 mbledhje online të kuvendit komunal, konstatojmë se gjatë vitit 2023 kemi numrin i mbledhjeve të transmetuara për 23 më shumë.

Në vijim, është paraqitur figura me të dhëna për komunat që kanë transmetuar mbledhjet online të kuvendit komunal.





Fig. 7 Mbledhjet e kuvendit komunal të transmetuar online

### PLANI I PUNËS SË KUVENDIT

Komunat kanë obligim ligjor të sigurojnë qasje të drejtpërdrejtë në dokumente publike përmes faqes zyrtare të saj, si: planin e punës së kuvendit të komunës, strategjitë dhe dokumentet tjera të politikave të miratuara.





Gjatë periudhës Janar/ Dhjetor 2023, planin e punës të kuvendit komunal e kanë publikuar 28 komuna, ndërsa 10 komuna tjera nuk kanë publikuar planin e punës së kuvendit të komunës.

Referuar të dhënave të vitit 2022 konstatojmë se kemi ulje në publikimin e planit së punës së kuvendit të komunës për tri (3)komuna më pak në vitin 2023.

Në vijmë figura pasqyron të dhënat e komunave që kanë publikuar Planin punës së kuvendit komunal.



Fig 8. Publikimi i planit të punës së kuvendit të komunës

### Plane dhe dokumente Strategjike

Të dhënat e verifikuara pasqyrojnë se Plane dhe dokumente Strategjike të fushave përkatëse gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2023 kanë publikuar 21 komuna, ndërsa 17 komuna nuk kanë publikuar asnjë plan dhe dokument strategjik.

Në vijmë kemi figurën që pasqyron numrin e komunave që kanë publikuar plane dhe dokumente strategjike të fushave përkatëse gjatë periudhës Janar- Dhjetor 2023.




Fig. 9 Planet dhe dokumente strategjike

### Hartat Zonale

Sipas të dhënave nga monitorimi i ueb faqeve zyrtare të komunave për periudhën Janar-Dhjetor 2023, prej 38 komunave Harta Zonale kanë publikuar 13 komuna, ndërsa 25 komuna nuk e kanë përmbushur ende këtë obligim ligjor.





Në vijmë është paraqitur figura me numrin e komunave që kanë publikuar Hartat Zonale.




Fig 10. Publikimi i hartave zonale

## PLANI I VEPRIMIT PËR TRANSPARENÇË

Udhëzimi Administrativ Nr.2023/04 për Administratë të hapur në komuna, përcakton obligimin që kanë Komunitat që të hartojnë planin katër (4) vjeçar të veprimit për transparencë. Ky plan, kërkohet të përfshijë veprime që promovojnë: mbledhjet e kuvendit të komunës, komiteteve, takimet publike, takimet konsultative për projekte, transparencën në planifikimin dhe shfrytëzimin e buxhetit të komunës, qasje të shpejtë në shërbime, procedurat transparente të prokurimit, procedurat e punësimit, përditësimin e aktiviteteve ditore në faqe zyrtare, përfshirjen aktive të qytetarëve në vendimmarrje etj. Plani i veprimit për transparencë komunale ka për qëllim t'i ofroj publikut qasje të lehtë në monitorimin dhe zbatimin e politikave nga organet komunale, duke përfshirë: informim të shpejtë, të dhëna të qasshme, publikim të gjitha akteve normative dhe dokumenteve me interes publik, si dhe rritje të mundësive të pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset vendimmarrëse.

Objektiv kryesor i Planit të Veprimit për Transparencë Komunale është “të siguroj qeverisje të hapur për qytetarë, gjithë përfshirje në procesin e planifikimit dhe zhvillimit të politikave, si dhe qeverisje transparente dhe llogaridhënëse”.

- Sigurimi i një kornize të qartë të planifikimit të organizuar, ku përcaktohen rolet e të gjithë pjesëmarrësve përgjegjës për transparencë komunale.
- Fuqizimi i mekanizmave lokal të demokracisë për të krijuar një publik të interesuar për çështje publike;
- Avancimi i mekanizmave të informimit, në mënyrë që qytetarët të dëgjohen dhe të inkurajohen për të qenë aktiv në proceset vendimmarrëse.
- Krijimi i një sistemi efektiv qeverisës, në të cilin parim kryesor i draftimit të politikave është baza e informacionit.
- Të dhënat nga monitorimi i komunave për periudhën raportuese Janar/Dhjetor 2023 tregojnë se Planin e Veprimit për Transparencë e kanë publikuar 29 komuna, ndërsa 9 komuna nuk kanë publikuar PVT.





- Në vijmë është paraqitur figura me numrin e komunave që kanë publikuar Planin e Veprimit për transparencë.




Fig 11. Plani i veprimit për transparencë komunale

### RREGULLORE PËR TRANSPARENCË

Bazuar në Ligjin për vetëqeverisje lokale Nr. 03/L-040, neni 68 paragrafi 68.4 përcakton se Kuvendi i komunës miraton rregulloren komunale që promovon transparencë të organeve legjislative, ekzekutive dhe administrative të komunës, duke e rritur pjesëmarrjen e opinionit në marrjen e vendimeve në nivel lokal, dhe duke lehtësuar qasjen publike në dokumentet zyrtare të komunës.

Të dhënat nga ueb faqja zyrtare pasqyrojnë periudhën raportuese Janar/Dhjetor 2023, ku sipas këtyre të dhënave Rregulloren për Transparencë në komuna e kanë publikuar 23 komuna, ndërsa 15 komuna nuk e kanë publikuar Rregulloren për Transparencë.

Në vijim, është paraqitur figura me numrin e komunave që kanë publikuar Rregulloren për Transparencë.




Fig.12 Publikimi i rregullores për transparencë në komuna







## TRANSPARENCA E KRYETARIT TË KOMUNËS

Bazuar në Udhëzimin Administrativ Nr.04/2023 për Administratë të hapur në komuna, kryetari i komunës ofron transparencë për procesin e vendimmarrjes dhe administratës. Kryetari i komunës është përgjegjës për zbatimin e legjislacionit për publikimin e akteve të ekzekutivit dhe dokumenteve zyrtare në pajtueshmëri me Ligjin Nr.06/L-82 për mbrojtjen e të dhënave personale dhe Ligjin Nr.061/081 për qasje në dokumente publike

Gjatë periudhës Janar/Dhjetor 2023, janë publikuar 6226 vendime të kryetarit nga 27 komuna, ndërsa 11 komuna tjera nuk kanë publikuar asnjë vendim të kryetarit.

Referuar të dhënave të vitit 2022 konstatojmë se kemi ulje në publikimin e vendimeve dhe rënie në numrin e komunave për dy (2)komuna më pak në vitin 2023.

Në vijim, është paraqitur figura me të dhëna për publikimin e vendimeve të kryetarit nga secila komunë ;




Fig 13 Publikimi i vendimeve të kryetarit të komunës

## PUBLIKIMI I RAPORTIT TË KRYETARIT

Ligji Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, neni 58 ka paraparë që kryetari i komunës është i obliguar të raportoj para kuvendit të komunës, së paku njëherë në gjashtë muaj apo kurdoherë që kërkohet nga kuvendi i komunës për situatën ekonomiko-financiare të komunës si dhe zbatimin e planeve investuese të komunës.

Në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr.04/2023 për Administratë të Hapur në komuna, raportet e kryetarit duhet të publikohen në ueb-faqen e komunës, bashkë me dokumentet tjera të obligueshme. Të gjeturat tregojnë se 27 komuna kanë publikuar raportin e kryetarit,





ndërsa 11 komuna nuk kanë publikuar në ueb faqe zyrtare të komunës asnjë raport të ekzekutivit.

Në krahasim me vitin 2022, ku raportin e kryetarit në faqen zyrtare e kishin të publikuar 25 komuna, në bazë të këtyre të dhënave konstatohet se ka rritje për dy (2) komuna më shumë në vitin 2023.

Në formë tabelore, është paraqitur numri i komunave që kanë publikuar raportin e kryetarit të komunës.




Fig. 14 Publikimi i Raportit të kryetarit të komunës

Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratë të hapur në komuna, përcakton se komuna obligohet të publikoj të gjitha dokumentet zyrtare, duke përfshirë Planin vjetor të punës së kryetarit dhe drejtorive.

Planin e punës së kryetarit të komunës gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2023, e kanë publikuar 25 komuna, ndërsa 13 komuna nuk kanë publikuar asnjë plan të punës së kryetarit të komunës.

Në formë tabelore, është paraqitur numri i komunave që kanë publikuar Planin e punës së kryetarit të komunës.




Fig.15. Plani i punës së Kryetarit të komunës





## TAKIMET E KRYETARIT

Çdo vit, komuna mban së paku dy takime publike me qytetarë për çështje të interesit të përgjithshëm. Njëri nga takimet publike duhet të mbahet në gjashtë (6) mujorin e parë të vitit, ndërsa takimi tjetër mbahet në gjashtë (6) mujorin e dytë të vitit. Në takimet publike është e obliguar të marrin pjesë zyrtarët më të lartë të organeve të komunës si: Kryetari i Komunës, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, Drejtorët e Drejtorive, Kryetarët e Komiteteve dhe Zyrtarët kompetentë për çështje në diskutim publik. Takimet publike i udhëheq dhe i kryeson Kryetari i Komunës, apo përfaqësuesi i tij. Kryetari është i autorizuar ta caktoj rendin e ditës dhe procedurën për udhëheqje të diskutimeve.

**Raporti i funksionimit të komunave, pasqyron se gjatë vitit 2023, takimet publike me qytetarë i kanë realizuar 27 nga 2, ndërsa 5 komuna kanë mbajtur nga 1 takim me qytetarë.**

Komunat të cilat nuk kanë mbajtur asnjë takim publik me qytetarë brenda kësaj periudhe raportuese, janë komunat: Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan, Mitrovicë e Veriut, Novobërdë dhe Mamushë.

Referuar të dhënave nga monitorimi i faqeve zyrtare për periudhën Janar-Dhjetor 2023, rezulton se njoftime për takime me qytetarë kanë publikuar 25 komuna, prej tyre 23 komuna kanë publikuar nga 2 takime publike me qytetarë, ndërsa 2 komuna kanë publikuar vetëm nga 1 takim publik me qytetarë, përderisa 13 komuna tjera nuk kanë publikuar asnjë takim me qytetarë.

Krahasuar të dhënat nga **Raporti i funksionimit të komunave për periudhën raportuese 2023** dhe Raporti për Vlerësimin e Transparencës komunale 2023, mungon publikimi i 7 njoftimeve për takime publike të kryetarit të komunës me qytetarë.

Në formë tabelore janë paraqitur të dhënat e komunave në publikimin e njoftimeve për takime publike të kryetarit me qytetarë, për periudhën Janar/Dhjetor 2023.



Fig 16. Numri i njoftimeve për takimet që kanë realizuar kryetarët e komunave gjatë viti 2023





## Raporti për Qasje në dokumente Publike

Neni 31 i Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike ka përcaktuar se për të siguruar transparencë të plotë në punën e tyre dhe sa i përket qasjes në dokumente publike, institucionet publike përmes zyrtarit përgjegjës për qasje në dokumente publike, hartojnë një raport vjetor më së largu deri në fund të muajit Janar të vitit aktual, për periudhën deri më datën 31 Dhjetor të vitit paraprak, ku përfshihet numri i rasteve në të cilat institucioni publik ka lejuar qasjen, numrin e rasteve në të cilat institucioni publik ka refuzuar qasjen në dokumente, si dhe arsyet e këtyre refuzimeve.

Nga 38 komuna, 24 komuna kanë publikuar raportin për qasje në dokumente publike, ndërsa 14 komuna nuk kanë publikuar raportin për qasje në dokumente publike

Në vijmë, është paraqitur figura me numrin e komunave të cilat kanë publikuar

Raportin për Qasje në dokumente Publike.



Fig.17. Raporti për qasje në dokumente publike

## TRANSPARENCA FINANCIARE

Transparenca financiare është një nga kriteret kryesore të qeverisjes së mirë që ndikon në rritjen e llogaridhënies së organeve komunale para qytetarëve. Rëndësia e transparencës ndikon në aspekte të shumta duke përfshirë qëndrueshmërinë ekonomike, financiare, qeverisjen e mirë, si dhe në sistemin e përgjithshëm të administratës shtetërore. Përmes këtij parimi mundësohet hapja e administratës para shoqërisë, informimi për punën e saj mund të bëhet në mënyrë të ndryshme dhe në vëllim të ndryshëm, parim që mund të kufizohet vetëm në rastet e caktuara në legjislacionin e secilit vend. Transparenca financiare bënë që administrata të jetë e qasshme nga jashtë. Për këtë arsye ueb-faqet zyrtare të institucioneve publike janë platformat bazë dhe më të aplikueshmet për komunikimin e informatave për





qytetarë, dhënien e informacioneve për fushëveprimin e tyre, menaxhimin financiar, aktivitetet e prokurimit, si dhe qasjen në dokumentet publike.

Dokumentet financiare komunat janë të obliguara t’i bëjnë publike si planet vjetore buxhetore, kornizën afatmesme të shpenzimeve, njoftimet për dëgjime buxhetore, raportet 3 mujore financiare, raportet financiare vjetore, raportet e auditimit, listën e investimeve kapitale etj.

### PLANIFIKIMI I BUXHETIT

Planifikimi i buxhetit në komuna është kushti kryesor për llogaridhënie dhe për ta parandaluar keq menaxhimin me paranë publike. Publikimi i planit të buxhetit është një nga kriteret kryesore të qeverisjes së mirë që ndikon në rritjen e llogaridhënies së organeve komunale para qytetarëve.

Gjatë periudhës Janar/Dhjetor 2023 Planin e Buxhetit kanë publikuar 28 komuna, ndërsa 10 komuna nuk kanë përmbushur këtë obligim ligjor.

Bazuar në të dhënat e Raportit për Vlerësimin e transparencës për vitin 2022, konstatohet se kemi rënie në publikimin e buxhetit gjatë vitit 2023 për tri (3) komuna më pak.

Në formë tabelore, është paraqitur numri i komunave të cilat kanë publikuar Planin e Buxhetit.





Fig 18 Publikimi i Buxheti në komuna

### KORNIZA AFATMESME BUXHETORE

Korniza Afatmesme Buxhetore është dokument kryesor financiar, në të cilin hartohet buxheti vjetor për vitin vijues. Në Kornizën Afatmesme Buxhetore përcaktohen prioritete duke u bazuar në analizën gjithëpërfshirëse dhe planifikimin buxhetor për vitin vijues.

Sa i përket KAB-it. Komunat qëndrojnë përafërsisht njëjtë në përmbushjen e këtij obligimi ligjor si në fushën e planifikimit të buxhetit.





Gjatë kësaj periudhe, 29 komuna kanë publikuar Kornizën Afatmesme Buxhetore, përderisa 9 komuna nuk kanë publikuar KAB-in.

Marrë për bazë të dhënat nga Raporti i Transparencës për vitin 2022, tregojnë se viti 2023 shënon rënie në publikimin e KAB-it. Për tri (3) komuna më pakë.

Në formë tabelore, është paraqitur numri i komunave të cilat kanë publikuar Kornizën Afatmesëm Buxhetore gjatë kësaj periudhe.



Fig19. Publikimi i KAB-it

## RAPORTE PERIODIKE FINANCIARE

Krahas dokumenteve të planifikimit buxhetor, legjislacioni në fuqi i obligon komunat të bëjnë publike veprimtaritë e tyre financiare. Publikimi i raporteve periodike financiare lehtëson edhe aspektet e tjera të kontrollit të jashtëm, për të vlerësuar efikasitetin e punës së kuvendeve komunale, respektimin e ligjshmërisë, menaxhimin efikas financiar si dhe performancën e përgjithshme të ekzekutivit të komunës. Neni 45.4 i Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësive ka përcaktuar që, kryetari i komunës përveç se obligohet t'i përgatis, të njëjtat duhet t'i publikoj në ueb-faqen e komunës.

Gjatë vitit 2023, 29 komuna kanë publikuar raporte 3 mujore financiare, ndërsa 9 komuna nuk kanë publikuar asnjë raport tre (3) mujor financiar për vitin 2023..

Në formë tabelore, është paraqitur numri i komunave që kanë publikuar Raporte periodike.






Fig.20. Publikimi i raporteve periodike financiare

## RAPORTI VJETOR FINANCIAR

Raportin vjetor financiar e kanë publikuar 27 komuna, ndërsa 11 komuna kanë dështuar në përmbushjen e këtij obligimi ligjor.

Në formë tabelore, është paraqitur numri i komunave që kanë publikuar Raportin vjetor financiar.




Fig 21 Publikimi i raportit vjetor financiar

## Njoftime për takime buxhetore

Komuna obligohet të mbaj takime buxhetore me qytetarë të përcaktuar sipas Ligjit për Menaxhimin e Financave publike dhe përgjegjësi.

Takime buxhetore mbahen duke përdorur format dhe teknikat e konsultimit publik përfshirë: thirrjet, afatet, procesverbalet dhe hartimin e raporteve sipas dispozitave të këtij udhëzimi administrativ. Njoftimi për diskutime buxhetore së bashku me propozim-buxhetin dhe dokumentet shpjeguese, publikohet së paku 2 (dy) javë para takimit duke ndjekur procedurën e nenit 5 paragrafit 2. të Udhëzimit Administrativ Nr. 04/2023 për Administratë të haur në komuna.





Komuna mban edhe takime tjera konsultative në kuadër të lagjeve, vendbanimeve dhe lokacioneve tjera për çështje që lidhen me, projektet e komunës, zhvillimin ekonomik lokal, përdorimin e pronës së komunës, planifikimin hapësinor, investime, të hyrat e komunës, planifikimin e buxhetit të komunës si dhe çështje të tjera në interes të përgjithshëm.

Sa i përket takimeve Buxhetore, komunat qëndrojnë mirë në përmbushjen e këtij obligimi ligjor.

Gjatë vitit 2023, njoftime për diskutime buxhetore kanë publikuar 32 komuna 166 njoftime, ndërsa vetëm 6 komuna nuk kanë përmbushur këtë obligim ligjor.

Sipas të dhënave nga Raporti për Vlerësimin e Transparencës për vitin 2022, rezultojnë se te njoftimet për takime buxhetore kemi një ngritje për një (1) komunë më shumë në vitin 2023.

Në formë tabelore, është paraqitur numri i komunave të cilat kanë publikuar njoftime për takime/diskutimet buxhetore Janar- Dhjetor 2023.



Fig. 22 Publikimi i njoftimeve për diskutime buxhetore

## RAPORTI I AUDITORIT TË JASHTËM

Bazuar në nenin 27, paragrafi 27.2 i Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, të gjitha raportet e auditorit dhe përgjigjet e autoriteteve lokale bëhen publike. Publikimi i raportit të auditorit është një tjetër indikator me rëndësi, pasi në këtë formë i ofron publikut të dhëna se si janë menaxhuar paratë publike nën menaxhimin e komunave.

Gjatë vitit 2023, Raportin e Auditorit të Jashtëm e kanë publikuar 25 komuna, ndërsa 13 komuna nuk kanë përmbushur këtë obligim ligjor sipas kornizës ligjore për transparencë.

Krahasuar me të dhënat nga Raporti i Transparencës për vitin 2022, rezultojnë se kemi ngritje për katër (4) komuna më shumë gjatë vitit 2023 në publikimin Raportit të Auditorit të Jashtëm.

Në formë tabelore, është paraqitur numri i komunave që kanë publikuar Raportin e Auditorit të Jashtëm.







Fig.23 Raporti i Auditorit të jashtëm

### Lista e investimeve kapitale

Lista e investimeve kapitale është një dokument financiar dhe përcakton shpenzimet kapitale që rezultojnë të nevojshme për zbatimin e vendimeve, të planeve të caktuara në komuna. Lista e investimeve kapitale përcakton kohën e realizimit, koston, burimet e financimit si dhe informacione të tjera të detajuara. Publikimi i Listës së shpenzimeve kapitale është pjesë e transparencës financiare dhe përcakton prioritetin më të lartë të sigurimit të fondeve, si dhe ndarjes buxhetore të nevojshme për financimin e rregullt të projektit kapital gjatë përgatitjes dhe miratimit të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës.

Sa i përket kategorisë së Investimeve Kapitale, gjatë kësaj periudhe 24 komuna kanë publikuar investime kapitale, ndërsa 14 komuna nuk kanë përmbushur këtë obligim ligjor.

Krahasuar me të dhënat nga Raporti i Transparencës për vitin 2022, rezulton se kemi ngritje për tri (3) komuna më shumë gjatë vitit 2023 në publikimin e Listës së Investimeve Kapitale.

Në formë tabelore, është paraqitur numri i komunave të cilat kanë publikuar Listën e Investimeve Kapitale.



Fig 24 Publikimi i listës së investimeve kapitale





## TRANSPARENCA NË PROKURIMIN PUBLIK

Prokurimi publik është ndër proceset më të ndjeshme për secilën organizatë buxhetore, për të cilën kërkohet transparencë dhe llogaridhënie e plotë sipas rregullave ligjore. Autoritetet komunale janë të obliguara me ligj që të përpilojnë një plan të prokurimit ku duhet të planifikojnë projektet, shërbimet si dhe kostot për secilin projekt e shërbim në këtë plan. Plani i prokurimit komunal duhet të përpilohet dhe publikohet në tre muajt e parë të vitit. Po ashtu, komunat si autoritete kontraktuese në bazë të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik nga KRPP duhet të ofrojnë informata për njoftimet për kontratë, njoftimet për anulime të aktiviteteve të prokurimit si dhe njoftimet e dhënies së kontratave/njoftimet e rezultateve të konkursit të projektimit, pavarësisht nga lloji apo vlera e parashikuar.

### PUBLIKIMI I PLANIT TË PROKURIMIT

Ligji Nr.04/L-042 për prokurimin publik ka përcaktuar se jo më pak se gjashtëdhjetë (60) ditë para fillimit të çdo viti fiskal, secili autoritet kontraktues duhet të përgatis, planifikimin paraprak të prokurimit, me shkrim, në të cilat identifikohen detaje të arsyeshme të të gjitha furnizimeve, shërbimeve dhe punëve që autoriteti kontraktues parashihet t'i prokurojë gjatë vitit fiskal, në fjalë. Planifikimet e prokurimit janë të rëndësishme sepse përcaktojnë të gjitha kërkesat e pritshme që do të prokurohen gjatë një periudhe, jep një afat kohor të realizimit të këtyre kërkesave, si dhe parashikon vlerën e prokurimit.

Sipas të dhënave nga Raporti për Vlerësimin e Transparencës në komuna për periudhën raportuese, 28 komuna kanë publikuar planin vjetor të prokurimit publik, ndërsa 10 komuna nuk e kanë publikuar planin e prokurimit 2023.

Krahasuar me të dhënat nga Raporti i Transparencës për vitin 2022, rezulton se kemi rënie për dy (2) komuna më pak gjatë vitit 2023 në publikimin e Planit të Prokurimit.

Në formë tabelore, është paraqitur numri i komunave që kanë publikuar Planin e Prokurimit.




Fig.25 Publikimi i Planit të Prokurimit





## RAPORTI I PROKURIMIT

Për çdo kontratë ose marrëveshje kuadër që mbulohet nga ligji në fuqi, dhe sa herë që krijohet një sistem dinamik blerjeje, autoriteti ose enti kontraktor harton një raport me shkrim, që përcakton emrin dhe adresën e autoritetit ose entit kontraktor, objektin dhe vlerën e përlllogaritur të kontratës, të marrëveshjes kuadër ose sistemit dinamik të blerjes sipas rastit. Raportet e prokurimit pasqyrojnë shpenzimet e parasë publike përmes prokurimit publik. Referuar të dhënave nga Raporti për Vlerësimin e Transparencës në komuna për periudhën raportuese, 12 komuna nuk e kanë publikuar Raportin vjetor të Prokurimit publik, ndërsa 26 komuna e kanë publikuar Raportin e Prokurimit për vitin 2022.

Në vijim, në formë tabelore është paraqitur numri i komunave të cilat kanë publikuar Raportin e Prokurimit.



Fig 26. Publikimi i raportit të prokurimit

## ZBATIMI I STANDARDEVE MINIMALE TË KONUSULTIMEVE PUBLIKE

Udhëzimi administrativ Nr. 04/2023 për Administratë të hapur në komuna ka pacaktuar standarde minimale të konsultimit publik, obligon autoritetet lokale që të sigurojnë pjesëmarrjen e qytetarëve dhe palëve të tjera të interesuara gjatë procesit të politik bërjes dhe vendimmarrjes në nivel lokal, të promovoj transparencën komunale, si dhe të ndikoj në zhvillimin e politikave të qëndrueshme në interes të përgjithshëm.

Ky udhëzim administrativ përcakton rregullat, parimet, format, procedurat dhe standardet minimale të konsultimit publik në komuna me rastin e zhvillimit të politikave dhe akteve nënligjore të komunës. Komuna është e obliguar të ofroj konsultim publik për të gjitha dokumentet e politikave lokale, si në vijim:

1. Aktet e komunës që i nënshtrohen procesit të konsultimit publike;
2. Draft -Statuti i Komunës;





3. Projekt-rregulloret komunale;
4. Projekt-buxhetin e komunës për vitin vijues, si dhe rishikimin buxhetor;
5. Kornizën afatmesme buxhetore për 3 vitet e ardhshme;
6. Strategjitë zhvillimore dhe planet e veprimit në nivel lokal në kuadër të fushave sektoriale;
7. Të gjitha projekt-planet hapësinore në nivel lokal, të përcaktuar me legjislacionin për planifikim hapësinor;
8. Të gjitha dokumentet tjera, për të cilat komuna vlerësojnë se janë të nevojshme të kalojnë në konsultim publik;

## PLANI I KONSULTIMEVE PUBLIKE

Bazuar në nenin 20 të Udhëzimit Administrativ Nr. 04/2023 për Administratë të hapur në komuna, Plani i konsultimeve publike duhet të publikohet në ueb faqen zyrtare të komunes. Planifikimi i përgjithshëm i konsultimeve publike bëhet që në fazën e hershme gjatë hartimit të planit të punës së komunës për vitin e ardhshëm kalendarik, si dhe me rastin e hartimit të planit për komunikim me publikun

Sipas të dhënave nga monitorimi i ueb faqeve të komunave, kemi si në vijim; 22 komuna kanë publikuar Planifikimin e Konsultimeve Publike, ndërsa 16 komuna nuk e kanë publikuar Planifikimin e Konsultimeve Publike në komuna.

Krahasuar me të dhënat nga Raporti i transparencës për vitin 2022, rezulton se kemi ngritje për dy (2) komuna më shumë gjatë vitit 2023 në publikimin e Planit të konsultimit publike.

Në vijim, në formë tabelore është paraqitur numri i komunave që kanë publikuar Planin për konsultim publik gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2023



Fig.27 Planifikimi i planit të konsultimeve publike





## Projekt-propozimet për konsultim publik

Projekt-propozimet të cilat i nënshtrohen konsultimit publik duhet të jenë të qarta dhe kompletuara me të gjitha dokumentet përcjellëse.

Gjatë kësaj periudhe komunat kanë publikuar edhe projekt propozime dhe projekt akte.

Sipas të dhënave nga monitorimi i ueb faqeve të komunave 19 komuna kanë publikuar në ueb faqe zyrtare 155 Projekt Akte, Projekt Propozime, ndërsa 19 komuna tjera nuk kanë përmbushur këtë obligim ligjor.

Në vijim, në formë tabelore është paraqitur numri i komunave që kanë publikuar Projekt-Propozime për konsultim publik gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2023.




Fig27. Numri i projekt-propozimeve të publikuar për konsultime publike


## Raporte për Konsultime Publike

Udhëzimit Administrativ Nr. 04/2023 për Administratë të hapur në komuna, përcakton se Zyrtari përgjegjës për hartim të projekt-propozimit gjatë mbajtjes së konsultimit publik mbledh komentet dhe përgatit raport për rezultatet e konsultimit publik. Shqyrtimi i komenteve bëhet nga grupi punues i projekt propozimit i cili vendos për pranimin ose refuzimin e rekomandimeve të marra nga palët e interesuara. Të gjitha propozimet, vërejtjet dhe sugjerimet që janë paraqitur nga publiku brenda mënyrës dhe afatit kohor të përcaktuar me Udhëzimit Administrativ Nr. 04/2023 për Administratë të hapur në komuna, përfshihen në raportin mbi shqyrtimin publik.

Sa i përket publikimit të numrit të Raporteve për Konsultime Publike, komunat qëndrojnë relativisht mirë.

Gjatë vitit 2023, Raporte për Konsultime Publike i kanë publikuar 21 komuna, ndërsa 17 komuna nuk kanë përmbushur këtë obligim ligjor.





Bazuar në të dhënat e Raportit për Vlerësimin e Transparencës të vitit 2022, konstatojmë se këtu kemi rritje për dy komuna më shumë në publikimi e raporteve për konsultime publike

Në vijim, në formë tabelore është paraqitur numri i komunave që kanë publikuar Raportet për konsultime publike.




Fig. 28 Numrin e raporteve për konsultime publike

Bazuar në neni 27 të Udhëzimit Administrativ Nr.04/2023 për Administratë të hapur në komuna, Organi propozues siguron kushte për zhvillimin e konsultimit me shkrim dhe në formë elektronike, duke përfshirë informimin me kohë për mënyrat dhe afatet e konsultimit publik.

Njoftimi me shkrim dhe elektronik, përmban: Projekt propozimin për të cilin kërkohen komentet, Adresën e saktë ku duhet të dërgohen komentet me shkrim dhe elektronike, Informatat (emrin, mbiemrin dhe e-mailin) për personin përgjegjës për pranimin e komenteve dhe Afatin për dorëzimin e komenteve.

Njoftime për konsultime Publike gjatë periudhës Janar–Dhjetor 2023, i kanë publikuar 25 komuna, ndërsa 13 komuna nuk kanë publikuar asnjë njoftim.

Ne forme tabelore kemi numrin e njoftimeve për konsultime publike për secilin komuna



Fig. 29 Njoftimet për konsultime publike





## PËRFUNDIME / REKOMANDIME

Në bazë të analizës së të dhënave të paraqitura në këtë raport, vihet re se obligimet ligjore në fushën e transparencës në disa komuna të Republikës së Kosovës gjatë vitit 2023, rezultojnë me ulje në disa obligime ligjore, por njëkohësisht ngecje dhe avancim në përmbushjen e obligimeve ligjore në disa prej komunave.

Mosfunksionimi i ueb faqes zyrtare të Komunave të Republikës së Kosovës, po shkakton probleme në përditësimin e të dhënave në ueb faqe zyrtare të komunave, vështirësi në monitorimin e faqeve zyrtare si dhe mbledhjen e të dhënave, vihet re se ka rezultuar me rënie dhe ngecje në përmbushjen e disa obligimeve ligjore të përcaktuara për komunat.


Pavarësisht, mosfunksionimi i ueb faqes zyrtare të Komunave të Republikës së Kosovës, që ka shkakuar ngecje në përmbushjen e disa obligimeve ligjore, komunat duhet të vazhdojnë kujdesin e tyre në njoftimin paraprak të palëve të interesit për mbajtjen e mbledhjeve të kuvendeve të komunave, takimeve, debateve, publikimin e akteve komunale dhe dokumenteve tjera publike, përmes ueb-faqeve zyrtare të komunave.

Komunat duhet t'i zbatojnë plotësisht obligimet ligjore që ka përcaktuar Udhëzimi Nr. 04/2023 për Administratë të hapur në komuna, dispozitave ligjore që rregullojnë fushën përkatëse si dhe Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2015 për ueb-faqet e Institucioneve Publike, që ueb faqet e institucioneve publike duhet të kenë të zhvilluar dhe të funksionalizuar modulën e kërkimit, i cili duhet të jetë i vendosur në ballinë. Moduli i kërkimit duhet të optimalizohet ashtu që dokumentet, informatat në ueb faqe të gjenden shpejt dhe lehtë. Kërkimi në bazë të shkronjave të para të fjalës së parë nga emërtimi i dokumentit, fajllit, datës, numrit etj. të ngjaj me shfletuesit më të avancuar në internet.

Duke pasur parasysh se problemi për mosfunksionim e ueb faqeve zyrtare ishte edhe në vitin 2022, vlerësimet për rënie, ngecja dhe ngritje të transparencës komunale janë krahasuar me të dhënat nga Raporti i vlerësimit të transparencës i vitit 2022 dhe Raportin e funksionimit të komunave për 2023, andaj rekomandojmë komunave të cilat nuk e kanë përmbushur këtë obligim ligjor të jenë më të vëmendshme në përmbushjen e obligimeve si në vijmë.

- ✓ Publikimi i ftesave për mbledhjet e kuvendit komunal
- ✓ Publikimi i ftesave për Komunitetin për Politike dhe financa dhe Komitetin për Komunitete
- ✓ Procesverbalet nga mbledhjet e kuvendit komunal dhe komiteteve.
- ✓ Transparenca buxhetore
- ✓ Aktet e Kryetarit të komunës





- ✓ Njoftimet për takimet e kryetarit me qytetarë
- ✓ Planin vjetor të prokurimit
- ✓ Raportin vjetor të prokurimit
- ✓ Komunitat duhet të publikojnë raportin e konsultimeve publike së bashku me projektin e propozuar për aprovim në kuvendin komunal.
- ✓ Komunitat duhet të vazhdojë që njoftimet për konsultime publike t'i vendos në linkun e Konsultimeve publike që të jenë të qasshme për palën e tretë.

